

Havushë Bunjaku - “99 Lule”

Qëllimi i këtij granti është që të ofroj përkrahje financiare për projektin e “Fidaneve dhe bimeve mjekuese” për “99 lule”.

Havushja Bunjaku ka themeluar kooperativën sociale “99 Lule” në Kishnicë, e cila merret me kultivimin, grumbullimin dhe përpunimin e bimëve mjekuese-aromatike dhe frutave shëruese.

Havushja është femra e parë në Kosovë që ka filluar një biznes të këtij lloji dhe me lulet që mbledh, i mobilizon shume gra të punojnë në mbledhje dhe paketim të luleve, dhe kështu sigurojnë nga pak të hyra për familjet e tyre.



Plasimi i produktit në treg si çaj natyral “99 Lule” me logo dhe me paketim unik dhe pëlqimi i produktit nga ana e konsumatorëve për Havushen është suksesi më i madh në jetë.

Havushja gjithashtu këtë vit, ka qenë njëra nga fituesit e garës për për “Ide Biznesi të Gjellbëra dhe Inovative 2015” që organizohet nga ne (FIQ).



Ajo përmes angazhimit të saj synon që të ndryshohet qasja e vendimmarrësve për bizneset e grave dhe veprimtaritë e grave dhe të mos ketë paragjykimë në shoqëri për fuqinë e grave.